



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 62

Tiranë – E enjte, 9 prill 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 11458, datë 27.3.2020	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 3489
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 141, datë 26.3.2020	Për miratimin e Rregullores së Funkcionimit dhe Organizimit të Komisionit të Regjistrimit të Produkteve Plehëruese..... 3489
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 142, datë 26.3. 2020	Për “Miratimin e përmbajtjes të të dhënave teknike të produkteve plehëruese”..... 3493
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 145, datë 26.3.2020	Për “Miratimin e klasifikimit të hollësishëm të produkteve plehëruese të lejuara për regjistrim”..... 3494

**DEKRET**

Nr. 11458, datë 27.3.2020

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, me propozim edhe të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Ardian Rexhep Pista
2. Ilir Xhafer Pnishi
3. Zymer Krasniqi
4. Ferhat Salih Pala
5. Furkan Şuayip Yurtseven
6. Giovanni Antonio Clemente
7. Rinë Fati Hyseni Kastrati (Hyseni)
8. Mehmet Edip Abakay
9. Selvete Ismail Gashi (Rama)
10. Armend Haxhi Haxhija
11. Albulena Agim Luli (Hamza)
12. Xhevdet Ahmet Qenaj
13. Noadia Vito Tutra (Mastrorosa)
14. Shkumbin Nysret Terpeza
15. Mesut Murat Yanar
16. Mohamad Rami Mohamad Hamami
17. Mergim Emin Mestani
18. Luciana Benedetto Acerra
19. Fati Shukri Hyseni
20. Gianni Domenico Marchegiani
21. Mehmet Şeref Aça
22. Rami Ghassa Nasri

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

URDHËR

Nr. 141, datë 26.3.2020

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË
FUNKSIONIMIT DHE ORGANIZIMIT
TË KOMISIONIT TË REGJISTRIMIT TË
PRODUKTEVE PLEHËRUESE**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 9 të ligjit 17/2020, “Për produktet plehëruese”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Rregulloreve të Funkcionimit dhe Organizimit të Komisionit të Produkteve Plehëruese, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Përgjithshme Rregullore dhe e Përputhshmërisë në Bujqësi, Ushqim dhe Zhvillim Rural, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

**MINISTRI I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi**

**RREGULLORE
PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË
RREGJISTRIMIT TË PRODUKTEVE
PLEHËRUESE****KREU I
“DISPOZITA TË PËRGJITHSHME****Neni 1
Objekti**

Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave të organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Rregjistrimit të Produkteve Plehëruese për aplikimin, shqyrtimin, miratimin dhe lëshimin e Çertifikatës së Rregjistrimit dhe



etiketës, dhe për çështje të tjera të lidhura me produktet plehëruese.

Neni 2 Përkufizime

Në kuptimin e kësaj rregulloreje:

a) “Komisioni” është Komisioni i Rregjistrimit të Produkteve Plehëruese.

b) “Ligji nr.17/2020”, është ligji nr.17/2020 “Për produktet plehëruese”

Përkufizimet e ligjit nr.17/2020 kanë të njëjtin kuptim në këtë rregullore.

Neni 3 Baza ligjore

Komisioni i Rregjistrimit të Produkteve Plehëruese funksionon dhe ushtron aktivitetin e tij në përputhje me Kushtetutën, ligjin nr.17/2020, Kodin e Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë, ligjin nr.8480 datë 27.5.1999 “Për organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, ligjin nr.9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, dhe aktet nënligjore përkatëse të miratuara në bazë të tyre.

Neni 4 Parimet e veprimtarisë

Në veprimtarinë e tij Komisioni respekton parimet e:

- Ligjshmërisë.
- Barazisë dhe mosdiskriminimit.
- Shqyrtimit brenda afateve.
- Transparencës.
- Mbrojtjen e të dhënave personale dhe sekretit tregtar.
- Parimit të ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit.
- Parimit të llogaridhënies.

KREU II ORGANIZIMI DHE VEPRIMTARIA

Neni 5 Organizimi

1. Komisioni është organ kolegjial, i përhershëm, që ushtron aktivitetin e tij në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

2. Komisioni përbëhet nga 7 anëtarë:

- zëvendësministri, i cili kryeson komisionin;
- dy përfaqësues nga SPPP-ja në ministri, i caktuar me urdhër të ministrit;
- një përfaqësues nga laboratorit i referencës, i caktuar me urdhër të ministrit;
- një përfaqësues nga Agjencitë Përgjegjëse për Këshillimin Bujqësor;
- një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për mjedisin;
- një përfaqësues nga shoqatat e fermerëve.

3. Sekretari i komisionit të regjistrimit të produkteve plehëruese është specialisti që mbulon produktet plehëruese pranë SPPP-së në ministri. Ministri në mënyrë të përkohshme cakton në këtë detyrë një nëpunës civil të ministrit.

4. Sekretari administron aplikimet, kërkesat dhe dokumentacionin, mban procesverbalin e mbledhjes, harton projektvendimet, vendimet dhe kryen çdo detyrë tjetër për mbarevajtjen e punës, si dhe kryen detyrat e caktuara nga kryetari. Sekretari i komisionit përditëson në faqen e ministrit formularin dhe dokumentacionin që duhet të paraqesë çdo subjekt aplikues dhe harton dhe publikon udhëzues.

5. Kryetari dhe anëtari i komisionit lirohet nga detyra kur:

- nuk është në marrëdhënie pune me institucionin përkatës,
- nuk ushtron detyrën për 3 mbledhje rresht,
- dënohet me vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale,
- për arsye të tjera të parashikuara nga ligji.

Neni 6 Kryetari dhe anëtarët e komisionit

1. Kryetari drejton dhe organizon veprimtarinë e komisionit, nënshkruan aktet e miratuara. Kryetari në veprimtarinë e tij asistohet nga sekretari i komisionit.



2. Kryetari delegon kryerjen e detyrave të veçanta që ligji nuk i ngarkon një subjekti të caktuar.

3. Anëtarët e komisionit marrin pjesë rregullisht në mbledhje. Anëtarët kanë të drejtë që para mbledhjes të njihen me rendin e ditës, dokumentacionin, dhe me projektvendimet.

Neni 7

Struktura përgjegjëse për produktet plehëruese dhe personeli ndihmës

1. SPPP zhvillon procedurat që lidhen me regjistrimin e produkteve plehëruese, në përputhje me kërkesat e ligjit dhe akteve të brendshme të ministrisë, ndjek e monitoron aktivitetin e produkteve plehëruese në nivel qendror dhe rajonal, në zbatim të këtij ligji.

2. Personeli i ministrisë kyen çdo detyrë ose jep çdo informacion të kërkuar nga kryetari i komisionit ose me urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm të ministrisë.

Neni 8

Rendi i ditës

Mbledhja e Komisionit zhvillohet në bazë të një rendi dite të përcaktuar.

Kryetari i Komisionit vendos për rendin e ditës, në bashkëpunim me sekretarin dhe SPPP.

Në rendin e ditës përfshihen të gjitha kërkesat duke respektuar radhën e aplikimeve online të kërkesave. Në rast kur ka kërkesa në formë shkresore ato futen në radhë sipas datës së paraqitjes në raport me radhën e aplikimeve online.

Rendi i ditës ndryshon me shumicë të thjeshtë, me kërkesë të kryetarit ose një anëtar i komisionit. Kërkesat për vendimarrje që nuk lidhen me aplikime shqyrton gjithmonë në fund të mbledhjes.

Neni 9

Mbledhja dhe votimi

1. Kryetari i Komisionit, ose sekretari me porosi të kryetarit, njofton anëtarët dhe subjektet e tjera të përcaktuara nga kryetari, në rrugë elektronike, për thirrjen e mbledhjes së Komisionit.

2. Njoftimi për mbledhje përmban rendin e ditës dhe dokumentacionin shoqërues.

2. Mbledhjet e Komisionit janë të vlefshme vetëm nëse në të janë të pranishëm shumica e thjeshtë e anëtarë, një prej të cilëve duhet të jetë kryetari.

3. Komisioni vendos mbi bazë dokumentesh me 2/3 e anëtarëve të pranishëm. Anëtarët e Komisionit nuk mund të abstenojnë. Votimi bëhet i hapur, anëtarët votojnë duke filluar nga anëtar i më i ri në moshë. Kryetari voton i fundit.

Në rast votash të barabarta, vota e kryetarit përcaktuese.

4. Anëtarët e Komisionit që kanë pengesë ligjore, nuk duhet të jenë të pranishëm gjatë shqyrtimit, diskutimit dhe votimit të çështjes ku kanë pengesë ligjore.

5. Në mbledhjet e Komisionit mund të ftohen të marrin pjesë punonjës të ministrisë ose të institucioneve të varësisë ose ekspertë të fushave të caktuara, pa të drejtë vote.

6. Gjatë zhvillimit të mbledhjes respektohen, por pa u kufizuar në to, rregullat e mëposhtme:

a) Respektimi i orarit të caktuar për zhvillimin e mbledhjes nga anëtarët;

b) Respektimi i rendit të ditës gjatë zhvillimit të mbledhjes;

c) Respektimi i kohës në dispozicion të anëtarëve pjesëmarrës për të parashtruar qëndrimin e tyre të ndryshëm, nëse ka, e cila përcaktohet nga kryetari.

ç) Çdo veprim tjetër të nevojshëm për mbarëvajtjen e mbledhjes.

Neni 10

Vendimet e Komisionit

1. Komisioni shqyrton në mënyrë të plotë aplikimin mbi:

a) etiketën përfundimtare të produktit plehërues, bazuar në etiketën e paraqitur nga aplikanti;

b) regjistrimin e produkteve plehëruese në procedurë regjistrimi;

c) reregjistrimin e produkteve plehëruese, sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 13, të ligjit;

d) çregjistrimin e produkteve plehëruese, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 13, të ligjit;

e) modifikimin e dokumentit të regjistrimit të produktit plehërues, sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 13, të ligjit.

2. Komisioni, pas shqyrtimit të kërkesës vendos:



a) Miratimin e rregjistrimit dhe etiketës përfundimtare; rirregjistrimin; çrregjistrimin e produkteve plehëruese; modifikimin e dokumentit të regjistrimit të produktit plehërues.

b) refuzimin e kërkesës,

c) kthimin e kërkesës për plotësim dokumentacioni,

d) kalimin e marrjes në shqyrtim të kërkesës në mbledhjen e radhës dhe kryerjen e veprimeve të caktuara

3. Vendimi, Certifikata e Rregjistrimit dhe Etiketa, nënshkruhen nga Kryetari dhe sekretari i komisionit, ndërsa procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari, anëtarët e komisionit dhe sekretari.

4. Kopje të vendimit, Certifikata e Rregjistrimit dhe Etiketa, procesverbalit dhe dokumentacioni të paraqitur depozitohen në arkivën e ministrisë, brenda 10 ditë pune nga data e dhënies së vendimit.

5. Sekretari i Komisionit, për qëllime statistikore, mban një regjistër në të cilin shënohen :

a) Të dhënat e aplikuesit dhe data e aplikimit,

b) dispozitivi për secilin aplikimin,

c) prodhuesin,

d) importuesin.

6. Sekretari jep infomacion të përditësuar në mënyrë elektronike, për zëvendës ministrin përgjegjës për bujqësinë dhe sekretarin e përgjithshëm të ministries në lidhje me produktet plehëruese të regjistruara.

Neni 11

Afatet e vlefshmërisë së rregjistrimit të produkteve plehëruese

1. Afati i vlefshmërisë së rregjistrimit të produkteve plehëruese është si vijon:

a) produktet plehëruese inorganike, me afat 4 vjeçar

b) produktet plehëruese organike, me afat 4 vjeçar

c) produktet plehëruese organo-minerare, me afat 4 vjeçar

ç) produktet plehëruese bazuar në elemente ushqyese dytësore, me afat 5 vjeçar

d) produktet plehëruese bazuar në mikroelemente, me afat 5 vjeçar

dh) produktet plehëruese me veprim specifik (frenuesit, biostimulantët e bimëve), me afat 7 vjeçar

e) produktet plehëruese të veçanta, me afat 7 vjeçar

ë) korrektuesit, me afat 7 vjeçar

f) substratet e kultivimit (rritjes), me afat 5 vjeçar;

g) përmirësuesit e tokës, me afat 7 vjeçar;

gj) materialet organike të destinuar për prodhimin e produkteve plehëruese organo-minerare, me afat 5 vjeçar.

Neni 12

Afati dhe vendimarrja

1. Komisioni merr vendim në themel për rregjistrimin e produkteve plehëruese, për çdo aplikim/kërkesë brenda afatit 20 ditor nga data e aplikimit në mënyrë të plotë që përfshin dhe paraqitjen e mostrës.

2. Komisioni merr vendime të tjera sipas afateve të parashikuara në ligj ose akte nënligjore.

3. Komisioni, në kryerjen e veprimeve procedurale vendos afate të arsyeshme për kryerjen e tyre por jo më të gjata se afatet ligjore

4. Komisioni mblidhet jo më pak se 1 herë në muaj.

Neni 13

Përfshirja

1. Kryetari ose anëtari i Komisionit nuk merr pjesë në vendimarrjen mbi një ankesë, kur ai gjendet në një nga rastet e konfliktit të interesit të parashikuar në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ose ka një pengesë ligjore.

2. Kur ekzistojnë shkaqet e mësipërme, anëtari i Komisionit njofton menjëherë kryetarin, i cili vendos mbi përfshirjen. Përfshirja e kryetarit vendoset nga ministri.

Neni 14

Konfidencialiteti i të dhënave

1. Anëtarët e Komisionit, sekretari, anëtarët e SPPP dhe çdo person tjetër që në ushtrimin e detyrave të tyre në kuadër të një procedure vendimarrjeje për shqyrtimin e një kërkesë, ruajnë të dhënat personale dhe të dhënat që lidhen me sekrete tregtare.



2. Kryetari i Komisionit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, merr masat për ruajtjen e të dhënave personale dhe të dhënave që përbëjnë sekret shtetëror apo tregtar.

3. Publikimi i të dhënave si detyrim që rrjedh nga ligji ose aktet nënligjore bëhet për aq sa ligji ose aktet nënligjore detyron publikim të dhënash.

URDHËR

Nr. 142, datë 26.3. 2020

PËR “MIRATIMIN E PËRMBAJTJES TË TË DHËNAVE TEKNIKE TË PRODUKTEVE PLEHËRUESE”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës si dhe të nenit 8, pika 5, të kreut II, të ligjit nr. 17/2020, datë 17.2.2020, “Për produktet plehëruese”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e përmbajtjes të të dhënave teknike të produkteve plehëruese, bashkëlidhur këtij urdhëri.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe e Përputhshmërisë në Bujqësi, Ushqim dhe Zhvillim Rural.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi

PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE TEKNIKE TË PRODUKTEVE PLEHËRUESE

Dokumentacioni teknik plotësohet nga prodhuesi. Dokumentacioni do të bëjë të mundur vlerësimin e përputhshmërisë së produktit plehërues me kërkesat përkatëse ligjore, dhe do të përfshijë një analizë dhe vlerësim adekuat të rreziqeve.

Informacioni i siguruar, të jetë i mjaftueshëm për të identifikuar me saktësi produktin plehërues dhe të bëjë përcaktimin e tij sipas grupeve.

Dokumentacioni teknik përmban të dhënat si vijon:

1. Emri i aplikantit dhe adresa e tij

Emri aplikantit:

Adresa:

Personi kontaktit:

Numër telefoni/cel:

Fax:

E-mail:

2. Emri i prodhuesit dhe adresa e tij

Emri shoqërisë prodhuese:

Adresa:

Personi kontaktit:

Numër telefoni/cel:

Fax:

E-mail:

3. Emri i importuesit në Shqipëri dhe adresa e tij

Emri shoqërisë:

Adresa:

Personi kontaktit:

Numër telefoni/cel:

Fax:

E-mail:

Emri i pakuesit, nëse kryhet paketimi në Shqipëri dhe adresa e tij.

4. Emri tregtar ose propozimi për emrin tregtar, i vendosur nga prodhuesi për produktin plehërues.

Të jepet emri i grupit përkatës, sipas përcaktimit të nenit 5, të ligjit nr 17/2020, si dhe emri tregtar.

Grupi:

Emri tregtar:

5. Informacion i detajuar sasior dhe cilësor mbi përbërjen e produktit plehërues

Përmbajtja e të gjithë përbërësve të produktit plehërues, përfshirë edhe përmbajtjen e elementëve të përshkruara me fjalë e simbole kimike dhe në lidhje me ushqyesit e format e tretshme.

Të dhënat e kësaj pike të shoqërohen dhe me certifikatën e analizës, të lëshuar prej prodhuesit të produktit plehërues.

Deklarata e pastërtisë (dhe informacioni i hollësishëm mbi papastërtitë) të lëndës/ve shoqëruese

Të jepet informacione mbi pastërtinë minimale të lëndës/ve shoqëruese (mbushëse).

Të bëhet një deklaratë që produkti plehërues nuk ka papastërti të rëndësishme toksikologjike, ekotoksikologjike ose mjedisore.

Të deklarohet përmbajtja e klorit, nëse ka.

Papastërtitë nuk duhet të kalojnë vlerat limit të përcaktuara në klasifikimin e hollësishëm të produkteve plehëruese.



6. Përdorimi

Të jepet një përshkrim i hollësishëm i produktit plehërues, që korrespondon me funksionin e kërkuar të tij si dhe përshkrimin e përdorimit të synuar, si vijon:

Funksioni (psh. ushqyes, përmirësues, korrektues, substrakt, etj.):

Përdorimi:

Mënyra e përdorimit:

Koha e përdorimit:

Sasia e përdorimit:

Numri i aplikimeve/sezon:

Kushtet e ruajtjes dhe magazinimit:

7. Veçoritë fizike, kimike dhe teknike të produktit plehërues

Gjendja fizike:

Ngjyra:

Aroma:

Aciditeti/alkaliniteti dhe vlera e pH:

Pika e shkrirjes:

Pika e vlimit:

Pika e ndezjes:

Shkalla e avullimit:

Ndezshmëria (e ngurtë, gaz):

Karakteristikat eksplozive:

Kufiri i ulët i shpërthimit:

Kufiri i sipërm i shpërthimit:

Presioni i avullit:

Dendësia e avullit:

Dendësia relative:

Tretshmeria në ujë:

Koeficienti i ndarjes (n-oktanol/uj):

Temperatura e vetëndezjes:

Temperatura e zbërthimit:

Viskoziteti:

Tensioni sipërfaqësor:

Karakteristikat oksiduese:

Stabiliteti i ruajtjes dhe afati i ruajtjes: efektet e temperaturës në karakteristikat teknike të produktit plehërues:

Përputhshmëria fizike dhe kimike e përzierjeve të rekomanduara në rezervuare (tanker):

Mospajtueshmëria e njohur të raportohet:

8. Paketimi dhe përputhshmëria

Natyra dhe karakteristikat e paketimit:

Të jepet informacion në lidhje me llojin, dimensionet, kapacitetin, madhësinë e hapjes, llojin e mbylljes, forcën, rrjedhshmërinë, rezistencën ndaj transportit, magazinimit dhe trajtimit (përdorimit).

Përshkrimi dhe specifikimi i paketimit:

Përshkrimi i materialit të paketimit (lloji, materialet, madhësia, madhësia e qafës së shishes për lëngjet, etj.), nëse kontejneri është i rimbushshëm ose i kthyeshëm, si dhe detaje të tjera.

Rezistenca e materialit paketues ndaj përmbajtjes së tij:

Të jepet informacioni/studimi i rezistencës së materialit për paketim, duke përfshirë udhëzimet që janë përdorur.

9. Udhëzime për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, sigurinë e mbrojtjes së mjedisit.

Të jepet informacioni për masat parambrojtëse dhe përkujesjes gjatë ruajtjes, transportit, tregtimit dhe përdorimit të produktit plehërues, trajtimin e ambalazheve, etj.

10. Të dhëna shtesë për produktet plehëruese të thjeshta me bazë nitrat amoni, me përmbajtje të lartë azoti

Prodhuësi të sigurojë dokumentacionin shtesë sipas kërkesave të pikës 5, të nenit 19, të ligjit nr. 17/2020.

URDHËR

Nr. 145, datë 26.3.2020

PËR “MIRATIMIN E KLASIFIKIMIT TË HOLLËSISHËM TË PRODUKTEVE PLEHËRUESE TË LEJUARA PËR REGJISTRIM”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës si dhe të nenit 5, pika 2, të kreut I, të Ligjit nr. 17/2020, datë 17.2.2020, “Për produktet plehëruese”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e klasifikimit të hollësishëm të produkteve plehëruese të lejuara për regjistrim, bashkëlidhur këtij urdhëri.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe e Përputhshmërisë në Bujqësi, Ushqim dhe Zhvillim Rural si dhe Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Fushë-Krujë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi



KLASIFIKIMI I HOLLËSISHËM I PRODUKTEVE PLEHËRUESE TË LEJUARA PËR REGJISTRIM

GRUPI A: PRODUKTET PLEHËRUESE INORGANIKE

NËNGRUP I A.1: PRODUKTE PLEHËRUESE TË THJESHTË, TË NGURTË

Të azotit (N)

Nr.	Përcaktimi i tipit	Të dhënat mbi metodën e prodhimit dhe përbërësit më të rëndësishëm	Përmbajtja minimale e lëndëve ushqyese (% e peshës). Të dhëna mbi shprehjen e lëndëve ushqyese, kërkesa të tjera	Të dhëna të tjera ose përcaktimi tipit	Përmbajtja e elementeve që do të deklarohen, forma e tretshmërisë
1	2	3	4	5	6
1.a.	Nitrat kalciumi	Produkt i përfutur kimikisht dhe që përmban si komponent kryesor nitrat kalciumi dhe po qe e nevojshme edhe nitrat amoni.	15% azot N. Azoti shprehet në azot total ose si azot nitrik dhe azot amoniakal. Përmbajtja maksimale e azotit amoniakal duhet të jetë 1.5%.		Azoti total Azot nitrik Azot amoniakal
1.b.	Nitrati i kalciumit dhe i magnezit	Produkt i përfutur kimikisht, që përmban si komponent kryesor nitrat kalciumi dhe nitrat magnezit.	13% azot N. Azoti shprehet si azot nitrik. Përmbajtja minimale e magnezit në formën e kripës së tretshme në ujë e shprehur si oksid magnezit: 5% MgO.		Azot nitrik Oksidi i magnezit tretshëm në ujë
1.c.	Nitrati i magnezit	Produkt i përfutur kimikisht, që përmban si komponent kryesor nitratin e magnezit.	10% azot N. Azoti i shprehur si azot nitrik. 14% oksid magnezit MgO. Magnezi i shprehur si oksid magnezit i tretshëm në ujë.	Tregtohet edhe në formë kristalore, duke e shënuar “në formë të kristalizuara”.	Azot nitrik Oksidi i magnezit tretshëm në ujë
2.a.	Nitrati i natriumit	Produkt i përfutur kimikisht, që përmban si komponent kryesor nitratin e natriumit.	15% azot N. Azoti i shprehur si azot nitrik.		Azot nitrik
2.b.	Nitrati i Kilit	Produkt i përgatitur prej caliche, që ka si komponent kryesor nitratin e natriumit.	15% azot. Azoti i shprehur si azot nitrik.		Azot nitrik
3.a.	Kalcio cinamide	Produkt i përfutur kimikisht, që përmban si komponent kryesor kalcio cinamide, përveç oksidit të kalciumit edhe sasi të vogla të kripërave të amonit dhe uresë.	18% azot N. Azoti i shprehur si azot total, ku të paktën 75% e azotit të deklaruar duhet të jetë në formën e azotit cianamidik.		Azoti total
3.b.	Nitrati kalcio cinamide	Produkt i përfutur kimikisht, që ka si komponent kryesor kalcio cinamide, përveç oksidit të kalciumit dhe në sasi të vogla edhe kripëra të amonit dhe të uresë si material shtesë të nitratis.	18% azot N. Azoti i shprehur si azot total, ku të paktën 75% e azotit të deklaruar të mos jetë azot nitrik, por vetëm në formën e azotit cianamidik. Përmbajtja e azotit nitrik: - minimale: 1% azot. - maksimale: 3% azot.		Azoti total Azot nitrik
4.	Sulfati i amonit	Produkt i përfutur kimikisht, që ka si komponent kryesor sulfatin e amonit.	20% azot N. Azoti i shprehur si azot amoniakal.		Azot amoniakal
5.	Nitrati i amonit, nitrati amonit (kalciumit)	Produkt i përfutur kimikisht, që ka si komponent kryesor nitratin e amonit dhe po qe e nevojshme edhe gur gëlqeror të bluar, sulfat kalciumi, gur dolomitesh të bluara, sulfat magnezit dhe kieserite.	20% azot N. Azoti i shprehur si azot nitrik dhe azot amoniakal që përbëjnë gjysmën e azotit të deklaruar.	Emërtimi “nitrat i Amonit gëlqeror” duhet të jetë për plehrat kimike, ku veç nitratis të amonit përmban edhe karbonat kalciumi dhe/ose karbonat magnezit dhe dolomite. Përmbajtja minimale e një karbonati të tillë do të jetë 20% dhe pastërtia jo më pak se 90%.	Azoti total Azot nitrik Azot amoniakal



6.	Sulfonitrati i amonit	Produkt i përfutur kimikisht që ka si komponent kryesor nitratin e amonit dhe sulfatin e amonit.	25% azot N. Azoti i shprehur si azot nitrik dhe azot amoniakal. Përbajtja minimale e azotit nitrik: 5%		Azoti total Azoti nitrik Azoti amoniakal
7.	Sulfonitrati magnezit	Produkt i përfutur kimikisht, që ka si komponent kryesor nitratin e amonit, sulfatin e amonit dhe sulfatin e magnezit	19% azot N. Azoti i shprehur si azot nitrik dhe azot amoniakal. Përbajtja minimale e azotit nitrik: 6%. 5% oksid magnezit MgO. Magnezi në formë kripe të tretshme në ujë e shprehur si oksid magnezit.		Azoti total Azoti nitrik Azoti amoniakal Oksidi i magnezit, i tretshëm në ujë
8.	Stückstoff magnezi (nitrati amoni magnezit)	Produkt i përfutur kimikisht, që ka si komponent kryesor nitratin, kripërat amoniakale dhe përbërësit e magnezit, si: dolomite, karbonat magnezit dhe/ose sulfat magnezit	19% azot N. Azoti i shprehur si azot nitrik dhe azot amoniakal. Përbajtja minimale e azotit nitrik: 6% 5% oksid magnezit. Magnezi i shprehur si oksid magnezit total.		Azoti total Azoti nitrik Azoti amoniakal Oksidi magnezit total i tretshëm në ujë
9.	Ure	Produkt i përfutur kimikisht, që ka si komponent kryesor diamide karbonike (karbamide)	44% azot N. Azoti total (biuretë e ngjeshur). Përbajtja maksimale e biuretës: 1.2%		Azoti total, i shprehur si azot ureik
10.	Krotonilidendiure	Produkt i përfutur nga reaksioni i uresë me aldeide krotonike. Përbërës monomerik.	28% azot N. Azoti i shprehur si azot total. Të paktën 25% e azotit krotonilidendiure Përbajtja maksimale e azotit ureik: 3%		Azoti total. Azoti ureik vetëm 1% e peshës. Azoti krotonilidendiure
11.	Isobutilidendiure.	Produkt i përfutur nga reaksioni i uresë me aldeide isobutirike. Përbërës monomerik.	28% azot N. Azoti i shprehur si azot total. Të paktën 25% e azotit isobutilidendiure. Përbajtja maksimale e azotit ureik: 3%		Azoti total Azoti ureik vetëm 1% e peshës Azoti isobutilidendiure
12.	Ure formaldeide.	Produkt i përfutur nga reaksioni i uresë me aldeide formike dhe përmban si komponent kryesor molekula të uresë formaldeide. Përbërës polimerik.	36% azot N. Azoti i shprehur si azot total. Të paktën 3/5 e përbajtjes së deklaruar e azotit total duhet të jetë e tretshme në ujë të ngrohtë. Të paktën 31% duhet të jetë azot i uresë formaldeide. Përbajtja maksimale e azotit ureik: 5%		Azoti total Azoti ureik, vetëm 1% e peshës Azoti i uresë formaldeide, i tretshëm në ujë të ftohtë. Azoti i uresë formaldeide, i tretshëm vetëm në ujë të ftohtë
13.	Plehra azotike Me përbajtje krotonilidendiure.	Produkt i përfutur kimikisht me përbajtje të krotonilidendiure dhe një pleh azotik të thjeshtë (sipas paragrafit A.1. produktet 3.a, 3.b. dhe 5).	18% azot N i shprehur si azot total. Të paktën 3% e azotit të jetë në formën amoniakale dhe/ose nitrike dhe/ose ureike. Të paktën 1/3 e përbajtjes së deklaruar e azotit total të rrjedhë nga krotonilidendiure. Përbajtja maksimale e biuretës: (azot ureik+azot krotonilidendiure) x 0.026.		Azoti total Për çdo formë duhet të jetë të paktën 1%: - azoti nitrik; - azoti amoniakal; - azoti ureik; - azoti krotonilidendiure.
14.	Plehra azotike Me përbajtje isobutilidendiure.	Produkt i përfutur kimikisht me përbajtje të isobutilidendiure dhe një pleh azotik të thjeshtë (sipas paragrafit A.1 produkte 3.a, 3.b. dhe 5).	18% azot N i shprehur si azot total. Të paktën 3% e azotit duhet të jetë në formën amoniakale dhe/ose ureike dhe/ose nitrike. Të paktën 1/3 e përbajtjes së deklaruar e azotit total të rrjedhë nga azoti isobutilidendiure. Përqindja maksimale e biuretës: (azot ureik + azot isobutilidendiure)		Azoti total. Për çdo formë duhet të jetë të paktën 1%: - azoti nitrik; - azoti amoniakal; - azoti ureik; - azoti isobutilidendiure.
15.	Pleh kimik azotik Me përbajtje Ure formaldeide.	Produkt i përfutur kimikisht me përbajtje të uresë formaldeide (metilenurea) dhe një pleh azotik të thjeshtë (sipas paragrafit A.1 produktet 3.a, 3.b. dhe 5).	18% azot i shprehur si azot total. Të paktën 3% e azotit duhet të jetë në formën amoniakale dhe/ose nitrike dhe/ose ureike Të paktën 1/3 e përbajtjes së deklaruar e azotit total duhet të rrjedhë nga urea formaldeide. Azoti i uresë formaldeide duhet të përmbajë të paktën 3/5 e azotit të tretshëm në ujë të ngrohtë. Përqindja maksimale e biuretës: (azot ureik + azot urea formaldeide) x 0.026.		Azoti total. Për çdo formë duhet të jetë të paktën 1%: - azoti nitrik; - azoti amoniakal; - azoti ureik; - azoti i uresë formaldeide i tretshëm në ujë të ftohtë; - azoti i uresë formaldeide i tretshëm vetëm në ujë të ngrohtë.



16.	Sulfati amonit me frenues të nitrifikimit(diciandiamide).	Produkt i përfuar kimikisht me përmbajtje të sulfatit të amonit dhe diciandiamide	20% azot N. Azoti i shprehur si azot total. Përmbajtja minimale e azotit amoniakal:18% Përmbajtja minimale e diciandiamide: 1.5% azotit		Azoti total Azoti amoniakal Azoti diciandiamide Informacione teknike
17.	Sulfonitrati amonit me frenues të nitrifikimit (diciandiamide).	Produkt i përfuar kimikisht me përmbajtje të sulfonitratit të amonit dhe diciandiamide.	24% azot N. Azoti i shprehur si azot total. Përmbajtja minimale e azotit nitrik: 3% Përmbajtja minimale e azotit diciandiamide: 1.5%		Azoti total Azoti nitrik Azoti amoniakal Azoti diciandiamide Informacione teknike
18.	Ure amoniosulfate.	Produkt i përfuar kimikisht nga sulfati i amonit.	30% azot N. Azoti i shprehur si azot amoniakal dhe azot ureik. Përmbajtja minimale e azotit amoniakal: 4% Përmbajtja minimale e shprehur si anhidrit sulfurik:12% Përmbajtja maksimale e biuretës: 0.9%		Azoti total. Azoti nitrik Azoti amoniakal. Anhidriti sulfurik i tretshëm në ujë.

Të fosforit (P)

Nr.	Përcaktimi i tipit	Të dhëna mbi metodën e prodhimit dhe përbërësit më të rëndësishëm	Përmbajtja minimale e lëndëve ushqyese (% e peshës) Të dhëna mbi shprehjen e lëndëve ushqyese Kërkesa të tjera	Të dhëna të tjera ose përcaktimi i tipit	Përmbajtja e elementeve që do të deklarohen. Format e tretshmërisë Kërkesa të tjera
1.	Skorie të shfosforizimit. Fosfati Tomas. Skorie Tomas.	Produkt i përfuar me anë të trajtimit nga metalurgjia e gëzës fosforore me përmbajtje si komponent kryesor silikofosfatit e kalciumit.	12% pentoksid fosfori P2O5. Fosfori i shprehur si anhidridi fosforik i tretshëm në acide minerale ku të paktën 75% e përmbajtjes së deklaruar e anhidridit fosforik të jetë e tretshme në acid citrik me 2% . Ose 10% P2O5 si anhidridi Fosfori shprehet fosforik i tretshëm në acid citrik me 2%. Bluarje e imët: Të paktën 75% duhet të kalojë nëpërmjet një site të imët 0.160m/m. Të paktën 96% duhet të kalojë nëpërmjet një site të imët 0.630m/m.		Përmbajtja e anhidridit fosforik total (e tretshme në acide minerale) nga e cila 75% (e shprehur në përqindje me peshën) të jetë e tretshme në acid citrik me 2% (për tregtimin në Francë, Itali, Spanjë, Portugali, Greqi, Republika Çeke, Estoni, Qipro, Letoni, Lituan, Hungari, Maltë, Poloni, Slloveni dhe Sllovaki.) Anhidridi fosforik total (i tretshëm në acide minerale) dhe anhidridi fosforik i tretshëm në acid citrik me 2% për vendet e rajonit. Anhidridi fosforik i tretshëm në acid citrik me 2% (për
2.a	Fosfati i thjeshtë	Produkt i përfuar nga reaksioni i fosfatit mineral i bluar me acidin sulfurik që përmban si komponent kryesor fosfatit monokalçik dhe sulfatin e kalciumit.	16% pentoksid fosfori P2O5. Fosfori i shprehur si pentoksid, fosfori i tretshëm në citrate amoni neutral, ku të paktën 93% e përmbajtjes së deklaruar e P2O5 duhet të jetë e tretshme në ujë. Pesha: 1 gr.		Anhidridi fosforik i tretshëm në citrat amoni neutral. Anhidridi fosforik i tretshëm në ujë.
2.b	Perfosfati koncentrat	Produkt i përfuar nga reaksioni i Fosfatit mineral i bluar me acidin sulfurik dhe acidin fosforik që përmban si komponent kryesor fosfatit monokalçik.	25% pentoksid fosfori P2O5. Fosfori i shprehur si pentoksid, fosfori i tretshëm në citrate amoni neutral, ku të paktën 93% e përmbajtjes së deklaruar e P2O5 duhet të jetë e tretshme në ujë. Pesha : 1 gr.		Anhidriti fosforik i tretshëm në citrate amoni neutral. Anhidridi fosforik i tretshëm në ujë.
2.c	Perfosfati I trefishtë	Produkt i përfuar nga reaksioni i Fosfatit mineral i bluar me acidin fosforik që përmban si komponent kryesor fosfatit monokalçik.	38% pentoksid fosfori P2O5. Fosfori i shprehur si pentoksid, fosfori i tretshëm në citrate amoni neutral, ku të paktën 85% e përmbajtjes së deklaruar e P2O5 të jetë e tretshme në ujë. Pesha : 3 gr.		Anhidridi fosforik i tretshëm në citrate amoni neutral.. Anhidridi fosforik i tretshëm në ujë.
3.	Fosfat natyral, pjesërisht i tretshëm	Produkt i përfuar nga bashkimi i pjesshëm i fosfatit natyral të bluar me acidin sulfurik ose me acidin fosforik që përmban si komponent kryesor fosfatit monokalçik, fosfatit trikalçik dhe	20% pentoksid fosfori P2O5. Fosfori i shprehur si pentoksid fosfori i tretshëm në acid mineral, ku të paktën 40% e përmbajtjes së deklaruar e P2O5 të jetë e tretshme në ujë.		Anhidridi fosforik total i tretshëm në acid mineral. Anhidridi fosforik i tretshëm në ujë.



		sulfatin e kalciumit.	Bluarje e imët: - Të paktën 90% të kalojë nëpërmjet një site të imët 0.160 m/m. - Të paktën 98% të kalojë nëpërmjet një site të imët 0.630 m/m.		
4.	Fosfat precipitat Bikalçik dihidrik	Produkt i përfutur me ndihmën e precipitimit në acidin fosforik si tretës të fosfatit mineral me përmbajtje të eshtrave me komponent kryesor fosfatit bikalçik dihidrik.	38% pentoksidi fosfori. Fosfori shprehet si P ₂ O ₅ i tretshëm në citrat amoni alkaline (Peterman). Bluarje e imët: - Të paktën 90% duhet të kalojë nëpërmjet një site të imët 0.160m/m. - Të paktën 98% duhet të kalojë nëpërmjet një site të imët 0.630m/m.		Anhidridi fosforik i tretshëm në citrat amoni alkaline.
5.	Fosfati termik	Produkt i përfutur nga reaksioni termik i fosfatit natyral i bluar me përbërës alkaline dhe acidin silicik që ka si komponent kryesor fosfatit kalçik alkaline dhe silikatin e kalciumit.	25% pentoksidi fosfori P ₂ O ₅ . Fosfori i shprehet si P ₂ O ₅ i tretshëm në citrat amoni alkaline (Peterman). Bluarje e imët: - Të paktën 75% duhet të kalojë nëpërmjet një site të imët 0.160m/m. - Të paktën 96% duhet të kalojë nëpërmjet një site të imët 0.630m/m.		Anhidridi fosforik i tretshëm në citrat amoni alkaline.
6.	Fosfati alumino kalçik	Produkt i përfutur në formë amorfe me ndihmën e trajtimit termik dhe i bluar që përmban si komponent kryesor fosfat kalçik dhe alumin.	30% pentoksidi fosfori P ₂ O ₅ . Fosfori i shprehet si P ₂ O ₅ i tretshëm në acid mineral, ku të paktën 75% e përmbajtjes së deklaruar e P ₂ O ₅ të jetë e tretshme në citrat amoni alkaline (Julie). Bluarje e imët: - Të paktën 90% duhet të kalojë nëpërmjet një site të imët 0.160 m/m. - Të paktën 98% duhet të kalojë nëpërmjet një site të imët 0.630 m/m.		Anhidridi fosforik total. Anhidridi fosforik i tretshëm në citrat amoni alkaline.
7.	Fosfati natyral i butë	Produkt i përfutur kimikisht nga bluarja e fosfatit natyral të butë që ka si komponent kryesor fosfatit trikalçik dhe karbonat kalciumi.	25% pentoksidi fosfori P ₂ O ₅ . Fosfori i shprehet si P ₂ O ₅ i tretshëm në acid mineral, ku të paktën 55% e përmbajtjes së deklaruar duhet të jetë e tretshme në acid formik me 2%. Bluarje e imët: - Të paktën 90% duhet të kalojë nëpërmjet një site të imët 0.063 m/m. - Të paktën 99% duhet të kalojë nëpërmjet një site të imët 0.125 m/m.		Anhidridi fosforik total i tretshëm në acid mineral. Anhidridi fosforik i tretshëm në acid formik me 2%. Përqindja e peshës së produktit që kalon nëpërmjet një site të imët 0.063m/m.

Të kaliumit (K)

Nr.	Përcaktimi i tipit	Të dhëna mbi metodën e prodhimit dhe përbërësit më të rëndësishëm	Përmbajtja minimale e lëndëve ushqyese (% e peshës) Të dhëna mbi shprehjen e lëndëve ushqyese Kërkesa të tjera	Të dhëna të tjera ose përcaktimi i tipit	Përmbajtja e elementeve që do të deklarohen Format e tretshmërisë Kërkesa të tjera
1	2	3	4	5	6
1.	Kripë e papërpunuar e potasit	Produkt i përfutur me bazë kripën e papërpunuar të potasit.	10% oksid potasi K ₂ O. Potasi i shprehet si K ₂ O tretshëm në ujë. 5% oksid magnezit MgO. Magnezi në formën e kripës së tretshme në ujë e shprehet si oksid magnezit.	Emri i zakonshëm tregtar.	Oksidi i potasit i tretshëm në ujë. i magnezit i Oksidi tretshëm në ujë.
2.	Kripë e papërpunuar e potasit, e pasuruar	Produkt i përfutur me bazë kripën e papërpunuar dhe të pasuruar të potasit me ndihmën e përzjerjes me klorur potasi.	18% oksid potasi K ₂ O. Potasi i shprehet si K ₂ O i tretshëm në ujë.	Emri i zakonshëm tregtar.	Oksidi i potasit i tretshëm në ujë. Paraqitje fakultative e përmbajtjes së oksidit të magnezit të tretshëm në ujë mbi 5% MgO.
3.	Klorur potasi	Produkt i përfutur me bazë kripën e papërpunuar të potasit me shtimin e kripës së magnezit që ka si komponent kryesor klorurin e potasit.	37% oksid potasi K ₂ O. Potasi i shprehet si K ₂ O i tretshëm në ujë.	Emri i zakonshëm tregtar.	Oksidi i potasit i tretshëm në ujë.
4.	Kripë potasi me përmbajtje kripë magnezit.	Produkt i përfutur me bazë kripën e papërpunuar të potasit me shtimin e kripës së magnezit që ka si komponent kryesor klorurin e potasit dhe kripën e magnezit.	37% oksid potasi K ₂ O. Potasi i shprehet si K ₂ O i tretshëm në ujë. 5% oksid magnezit MgO. Magnezi në formën e		Oksidi i potasit, i tretshëm në ujë. i magnezit, i Oksidi tretshëm në ujë.



			kripërave të tretshme në ujë e shprehur si oksid magnezit.		
5.	Sulfat potasi	Produkt i përfutur kimikisht nga kripërat e potasit që kanë si komponent kryesor sulfatin e potasit.	47% oksid potasi K ₂ O. Potasi i shprehur si K ₂ O i tretshëm në ujë. Përqindja maksimale e klorit: 3% Cl.		Oksidi i potasit i tretshëm në ujë. Paraqitja fakultative e përmbajtjes së klorit.
6.	Sulfati potasit me përmbajtje kripe të magnezit	Produkt i përfutur kimikisht nga kripa e potasit me shtimin e kripërave të magnezit që ka si komponent kryesor sulfatin e potasit dhe sulfatin e magnezit.	22% oksid potasi K ₂ O. Potasi i shprehur si K ₂ O i tretshëm në ujë. 8% oksid magnezit MgO. Magnezi në formë të kripërave të tretshme në ujë si oksid magnezit. Përqindja maksimale e klorit: 3% Cl.	Emri i zakonshëm tregtar.	Oksidi i potasit i tretshëm në ujë. Oksidi i magnezit i tretshëm në ujë. Paraqitja fakultative e përmbajtjes së klorit Cl.
7	Kieserite me sulfat potasi	Produkt i përfutur nga kieserite me shtim të sulfatit të potasit.	8% oksid magnezit MgO. Magnezi i shprehur si MgO i tretshëm në ujë. 6% oksid potasi K ₂ O. Potasi i shprehur si K ₂ O i tretshëm në ujë. Përqindja maksimale e klorit: 3% Cl.	Emri i zakonshëm tregtar	Oksidi i magnezit i tretshëm në ujë. Oksidi i potasit i tretshëm në ujë. Paraqitja fakultative e përmbajtjes së klorit.

NËNGRUPË A.2: PRODUKTE PLEHËRUESE TË PËRBËRË, TË NGURTË

Azot-Fosfor-Kalium (NPK)

B.1.1.	Përcaktimi i tipit	N P K
	Të dhëna mbi metodën e prodhimit dhe përbërësit kryesorë	Produkt i përfutur kimikisht me përzierje pa shtim të lëndëve ushqyese organike me origjinë shtazore apo bimore
	Përmbajtja minimale e lëndëve ushqyese (% e peshës). Kërkesa të tjera	- Totale: 20% (N + P ₂ O ₅ + K ₂ O); - Për çdo lëndë ushqyese: 3% N, 5% P ₂ O ₅ , 5% K ₂ O

Forma, tretshmëria dhe përmbajtja e lëndëve ushqyese që do të deklarohen në kolonat 4, 5 dhe 6			Të dhëna për identifikimin e plehrave kimike		
Bluarje e imët			Kërkesa të tjera		
N	P ₂ O ₅	K ₂ O	N	P ₂ O ₅	K ₂ O
1	2	3	4	5	6
(1) Azoti total (2) Azoti nitrik (3) Azoti amoniakal (4) Azoti ureik (5) Azoti cianamidik	(1) P ₂ O ₅ i tretshëm në ujë. (2) P ₂ O ₅ i tretshëm në citrat amoni neutral. (3) P ₂ O ₅ i tretshëm në citrat amoni dhe në ujë. (4) P ₂ O ₅ i tretshëm vetëm në acid mineral. (5) P ₂ O ₅ i tretshëm në citrat amoni alkalin (Peterman) (6.a.) P ₂ O ₅ i tretshëm në acid mineral ku të paktën 75% e përmbajtjes së deklaruar e P ₂ O ₅ të jetë e tretshme në acid citrik me 2%.	K ₂ O i tretshëm në ujë.	(1) Azoti total. (2) Një nga format e azotit si (2) dhe (5) duhet të arrijë të paktën 1% të peshës së deklaruar. Azoti total mbi 28% duhet t'i përafrohet shtojcës 3.2.	1. Një pleh kimik NPK pa skore Tomas, fosfat termik, fosfat aluminokalçik, fosfat natyral pjesërisht i tretshëm dhe fosfat natyral, janë konfirmuar deklarimet e tretshmërisë (1), (2) ose (3). - Kur P ₂ O ₅ e tretshme në ujë arrijnë në 2% e deklaruar në (3), është e detyrueshme të tregohet Në përmbajtjen e P ₂ O ₅ tretshmëria në ujë [tretshmëria (1)]. Përmbajtja e P ₂ O ₅ e tretshme në acid mineral nuk duhet të jetë mbi 2%. Për tipin 1 sasia e peshës për Përcaktimin e tretshmërisë (2) dhe (3) është 1 gr.	Oksidi i potasit i tretshëm në ujë. Të shprehur përqindja e klorit ku t'i përgjigjet përqindjes maksimale të Cl. Pranohet deklarimi i përqindjes së Cl.
